



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.21

2001

Maj

P Ë R M B A J T J A

Udhëzim i KQZ nr.26, datë 28.4.2001	Për verifikimin e listave paraprake të zgjedhësve nga ana e partive politike.....	647
Udhëzim i KQZ nr.27, datë 28.4.2001	Për kohën e punës së KZQV-ve.....	650
Udhëzim i KQZ nr.29, datë 5.5.2001	Mbi të drejtat që kanë anëtarët pa të drejtë vote pranë komisioneve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e datës 24.6.2001.....	650
Udhëzim i KQZ nr.30, datë 5.5.2001	Për paraqitjen e dokumenteve dhe regjistrimin e kandidatëve për deputet për zgjedhjet e Kuvendit 2001...	653
Udhëzim i KQZ nr.31, datë 5.5.2001	Për caktimin e afateve kur subjektet zgjedhore duhet të paraqesin përfaqësuesit e tyre për ngritjen e KZZ-ve.....	654

Udhëzim i KQZ nr.32, datë 8.5.2001	Për regjistrimin e partive politike dhe koalicioneve.....	655
Udhëzim i KQZ nr.33, datë 8.5.2001	Për regjistrimin e studentëve në listat e zgjedhësve për zgjedhjet e Kuvendit 2001.....	656

U D H Ë Z I M
Nr.26, datë 28.4.2001

PËR VERIFIKIMIN E LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE
NGA ANA E PARTIVE POLITIKE

Në mbështetje të nenit 54 pika 2 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe me propozim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për rishikimin e listave të zgjedhësve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Për verifikimin e listave paraprake të zgjedhësve, partitë politike mund të krijojnë grupe verifikimi në Zyrat e Gjendjes Civile. Këto grupe përbëhen nga tre anëtarë, dy prej të cilëve janë përkatësisht përfaqësues të pozitës dhe opozitës, ndërsa anëtari i tretë është punonjës i Zyrës së Gjendjes Civile. Dy anëtarët e partive politike vihen në dispozicion të KZQV-së përkatëse dhe mandatohen menjëherë prej saj.

2. Ky proces verifikimi kryhet në përputhje me aktet që normojnë punën e Zyrës së Gjendjes Civile. Ky proces verifikimi është pa pagesë, me shpenzimet e subjekteve dhe nuk duhet të vijë në kundërshtim me rregullimet e tjera të përcaktuara nga KQZ-ja për rishikimin e listave paraprake.

3. Grupi tresh, i krijuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, kryen punën në përputhje me ligjin “Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e tjera të nxjerra nga KQZ-ja, dhe, kur vëren se një emër zgjedhësi mungon në listën paraprake, plotëson formularin sipas modelit bashkëngjitur.

4. Ky formular duhet të firmoset nga të tre anëtarët e këtij grupi dhe të vuloset me vulat e subjekteve lokale që përfaqësojnë, dhe nga Zyra e Gjendjes Civile. Formulari, së bashku me një kërkesë i dërgohet KZQV-së. KQZ-ja, pasi merr kërkesën nga KZQV-ja, verifikon nëse personat e shënuar në formular janë ose jo në listën paraprake. Pasi bën verifikimin, KQZ-ja, dërgon raportin e kompjuterizuar në KZQV. Kjo e fundit, mbi bazën e këtij raporti, ndjek procedurat ligjore, si dhe ato të përcaktuara në Anex 1. KZQV-ja ka të drejtë të përdorë grupin e krijuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, pa punonjësin e Zyrës së Gjendjes Civile dhe të plotësuar me një punonjës të pushtetit vendor, për të realizuar verifikimin për personat që nuk janë gjetur në bazën e të dhënave.

5. Rishikimi në Zyrat e Gjendjes Civile nuk duhet të kalojë datën 15 maj 2001. Afati për paraqitjen e kërkesave, sipas këtij udhëzimi nuk mund të jetë më shumë se dy ditë, duke filluar nga data 15 maj 2001. KQZ-ja shprehet me vendim, në lidhje me kërkesën, brenda datës 25 maj 2001.

6. Përshkrimi teknik i procedurave që do të ndiqen për këtë rishikim paraqitet në Anex 1.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

ANEX 1

Procedurat për rishikimin e listave paraprake nga ana e partive politike

- Partitë caktojnë anëtarët e tyre në grupet e rishikimit që do ngrihen pranë KZQV-së para depozitimit të kërkesës për rishikim.

- KZQV-të njoftojnë, me anë të një shkrese, Zyrat e Gjendjes Civile për procesin e rishikimit që do të realizohet, pjestarët e grupit, si dhe i kërkojnë asaj të caktojë një punonjës të saj.

- Grupi i verifikimit punon së bashku dhe që të tre anëtarët duhet të nënshkruajnë çdo dokument.

- Nuk duhet të bëhen ndryshime në përbërje të grupit në periudhën 2-15 maj.

- Orari i punës së grupit duhet të përputhet me orarin e punës së Zyrës së Gjendjes Civile.

- Puna në Zyrat e Gjendjes Civile përfundon më 15 maj 2001. Do të pranohen vetëm ato materiale që janë përgatitur deri në këtë datë.

- Nëse verifikohet mungesa e një personi në listë, grupi plotëson, për këtë, formularin përkatës (modeli bashkëngjitur), duke përfshirë në të të gjitha informacionet e kërkuara. Në rast të kundërt,

kërkimi në bazën e të dhënave bëhet i pamundur.

- Çdo ditë, grupi i rishikimit dorëzon në KZQV formularin e përgatitur gjatë ditës. KZQV-ja e merr atë dhe i jep grupit një faturë të nënshkruar nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari.

- Çdo fundjavë, duke filluar nga 5 maj 2001, KZQV-ja dërgon në KQZ formularët e grumbulluar.

- Nëse identiteti i një personi të regjistruar në formularin e rishikimit gjendet në bazën e të dhënave, KQZ-ja përpilon raportin e kompjuterizuar, lidhur me statusin e këtij emri, në bazën e të dhënave dhe ia dërgon atë KZQV-së për ta përfshirë në listën përfundimtare. Nëse KZQV-ja nuk është e bindur se ai është një zgjedhës i ligjshëm apo se nuk është banor i zonës në fjalë, ajo dërgon grupin e verifikimit për saktësim dhe në bazë të informacioneve që sjell grupi, vendos ta shtojë ose jo në listën përfundimtare.

- Të gjitha kërkimet, në bazën e të dhënave, sipas procedurës së mësipërme, duhet të përfundojnë më 25 maj 2001.

KQZ – Zgjedhësit që nuk gjenden në bazën e të dhënave

Rrethi _____ Bashkia/ Komuna _____ GjC
Nr. _____ f. _____

	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Adresa e plotë	Regjistri	Libri nr.	Faqe nr.
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								
16								
17								
18								
19								
20								
21								
22								
23								
24								
25								

Data ____ . ____ . ____

Anëtar _____ Anëtar _____

Anëtar _____

U D H Ë Z I M
Nr.27, datë 28.4.2001

PËR KOHËN E PUNËS SË KZQV-VE

Në mbështetje të nenit 18/2 dhe 38/7 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

U D H Ë Z O N:

1. Orari i punës i KZQV-ve dhe QRLZ-ve (Qendrave të Rishikimit të Listave të Zgjedhësve), gjatë gjithë periudhës së rishikimit të listave, duhet të jetë 8.00 – 12.00 paradreke dhe 15.00 – 19.00 mbasdite, pranë zyrave të bashkive, komunave apo njësive bashkiake përkatëse.

2. Gjatë periudhës së rishikimit të listave, anëtarët e KZQV-ve do të shkëpusin marrëdhëniet e punës që ato kanë me punëdhënësit e tjerë. Gjatë kësaj periudhe, në orën që përcaktohet në pikën nr.1 të këtij udhëzimi, ata do të punojnë pranë zyrave të bashkive, komunave apo njësive bashkiake.

3. Anëtarëve të KZQV-ve, që punojnë për këtë periudhë, do t’u ruhet vendi i punës dhe marrëdhëniet financiare do t’ju vazhdojnë rregullisht si më parë, pranë punëdhënësve të tyre.

4. Anëtarët e KZQV-ve, për periudhën që do të punojnë me kohën e punës të përcaktuar në këtë udhëzim, do të shpërblehen në masën që do të caktohet me vendim të veçantë të KQZ-së.

5. KZQV-të do të vazhdojnë të funksionojnë si institucion i përhershëm edhe për periudhën pasi ka mbaruar procesi zgjedhor.

Për këtë periudhë, anëtarët e KZQV-ve do të paraqiten në punë një herë në muaj, ditën e shtunë të javës së parë të muajit përkatës, nga ora 8.00 – 12.00 paradreke dhe shpërblimi për këtë punë të kryer do të caktohet me një vendim të veçantë të KQZ-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr.29, datë 5.5.2001

MBI TË DREJTAT QË KANË ANËTARËT PA TË DREJTË VOTE PRANË KOMISIONEVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E DATËS 24.6.2001.

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000, “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

I. Të përgjithshme

1.1 Ky udhëzim ka për qëllim detajimin e rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për përfaqësuesit e partive politike, që nuk kanë të drejtë vote.

1.2 Ky udhëzim rregullon statusin e anëtarit pa të drejtë vote në komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve.

1.3 Në kuptim të këtij udhëzimi, “anëtar pa të drejtë vote” do të quhen të gjithë përfaqësuesit e partive politike, pavarësisht nga koalicionet, që sipas Kodit Zgjedhor marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve zgjedhore të të gjitha niveleve, dhe që nuk kanë të drejtë vote.

1.4 Për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, anëtarë pa të drejtë vote do të konsiderohen edhe përfaqësuesit e kandidatëve të pavarur të akredituar pranë KZZ-ve, KZQV-ve dhe KQV-ve. Ata gëzojnë të njëjtin status, si dhe përfaqësuesit e partive politike.

II. Përfaqësuesit e partive politike në KQZ

2.1 Në përputhje me nenin 154 pika 4 të Kushtetutës, si dhe nenin 31 të Kodit Zgjedhor, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje caktojnë një përfaqësues të tyre në Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ).

2.2 Përfaqësuesit e partive politike kanë të drejtë të ndjekin të gjitha mbledhjet e hapura në KQZ. Në këto mbledhje, ata diskutojnë për çdo çështje që ata kanë mendime ose pretendime. KQZ-ja është e detyruar të dëgjojë çdo mendim apo pretendim të tyre.

2.3 Përfaqësuesit e partive në KQZ kanë të drejtë të marrin pjesë në seminarët trajnuese të organizuara nga KQZ-ja. KQZ-ja nuk është e detyruar të paguajë shpenzimet për pjesëmarrje për përfaqësuesit e partive politike.

2.4 Përfaqësuesit e partive politike në KQZ paraqesin mendimet e tyre me shkrim për çdo çështje që shtrohet për diskutim. Këto mendime mund të paraqiten si para mbledhjes, ashtu dhe gjatë mbledhjes së KQZ-së. KQZ-ja është e detyruar t'i shqyrtojë këtë mendime në mbledhjen më të afërt të saj, kur mendimet nuk janë paraqitur në mbledhje.

2.5 Për çdo ankesë ose pretendim të përfaqësuesve të partive politike që paraqitet në KQZ, pasi shqyrtohet në mbledhje të rregullt të KQZ-së, kthehet përgjigje me shkrim, jo më vonë se 24 orë nga momenti i marrjes së vendimit në KQZ. Përgjigja nënshkruhet nga kryetari i KQZ-së ose në mungesë të tij nga nënkryetari. Përgjigjes i bashkëngjitet edhe vendimi i KQZ-së i nënshkruar nga anëtarët e tij dhe i vulosur me vulë të njomë.

2.6 Përfaqësuesit e partive politike në KQZ kanë të drejtë të paraqesin jo vetëm sugjerime apo vërejtjet e partive të tyre, por edhe të kandidatëve që i mbështesin këto parti. Përfaqësuesit e partive, kur çmojnë se është e nevojshme për sqarimin e rrethanave mbi një çështje konkrete, sjellin në KQZ edhe kandidatët ose përfaqësuesit e tyre të akredituar, sipas rregullave të Kodit Zgjedhor. KQZ-ja është e detyruar që të dëgjojë drejtpërdrejt pretendimet e kandidatëve.

2.7 Përfaqësuesit e partive politike në KQZ kanë vendet e tyre në sallën e mbledhjeve. Vendosija e tyre bëhet në mënyrë të atillë që të mos shkaktojë konfuzion në komunikim me KQZ-në.

2.8 Materialet që diskutohen në mbledhjen e KQZ-së u vihen në dispozicion para dhe gjatë mbledhjes edhe përfaqësuesve të partive politike.

2.9 Përfaqësuesit e partive politike nuk mund të ndërhyjnë kur dikush tjetër është duke diskutuar. Ata kanë të drejtën e replikës, sa herë që u përmendet emri i tyre ose i partisë që përfaqësojnë.

2.10 KQZ-ja ka për detyrë që të njoftojë përfaqësuesit e partive politike në KQZ për orarin e mbledhjeve, si dhe të krijojë të gjitha lehtësirat për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e KQZ-së, sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në rregulloren e KQZ-së. Përfaqësuesit e partive politike në KQZ mbajnë në një vend të dukshëm dokumentin e identitetit të lëshuar nga KQZ-ja, sa herë që ato gjenden në ambientet e KQZ-së. Të gjitha vendimet dhe aktet e tjera të KQZ-së u jepen përfaqësuesve të partive politike, në bazë të kërkesës së tyre, pasi ato të zbardhen. Kërkesa, paraqitet me shkrim pranë sekretarit të KQZ-së, i cili është i detyruar që të marrë masa për dhënien e këtyre akteve, përveç rasteve kur KQZ-ja ka vendosur ndryshe.

2.11 Në rastet kur kandidatët e pavarur paraqesin ankesa në KQZ, atëherë KQZ-ja është e detyruar të dëgjojë edhe përfaqësuesin e kandidatit të pavarur të akredituar në KZZ ose KZQV, kur kjo gjë kërkohet nga vetë kandidati ose përfaqësuesi.

2.12 KQZ-ja merr masa që të paguajë anëtarët pa të drejtë vote të përcaktuar në këtë udhëzim, në përputhje me gjendjen financiare të krijuar. Në çdo rast, masa e shpërblimit nuk mund të jetë më shumë se gjysma e pagës së anëtarit me të drejtë vote të komisionit përkatës.

III. Përfaqësuesit e partive politike në KZQV dhe KZZ

3.1 Anëtarët pa të drejtë vote në KZZ apo KZQV, caktohen nga të gjitha ato parti politike që nuk kanë anëtarë me të drejtë vote në këto komisione.

3.2 Anëtarët pa të drejtë vote në këto komisione, qëndrojnë në këto komisione për atë kohë sa nuk janë zëvendësuar nga partitë e tyre.

3.3 Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje kanë të drejtë të dërgojnë anëtarë pa të drejtë vote në këto komisione në çdo kohë, duke filluar nga momenti kur KZZ-të apo KZQV-të kanë filluar aktivitetin e tyre. Në zbatim të kësaj pike KZZ-të, apo KZQV-të njoftojnë zyrtarisht partitë politike që të caktojnë këta anëtarë.

3.4 Përfaqësuesit e partive politike që nuk kanë anëtarë me të drejtë vote, pajisen me autorizim nga partia që ato përfaqësojnë dhe, pasi e depozitojnë në KZZ apo KZQV, konsiderohen anëtarë pa të drejtë vote në këto komisione.

3.5 Anëtarët pa të drejtë vote, sa herë që ndodhen në ambientet e KZZ-ve apo KZQV-ve,

duhet të mbajnë varur në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga KZZ-të apo KZQV-të.

3.6 Përfaqësuesit e partive politike në KZZ gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime, si dhe anëtarët e KZZ-ve dhe KZQV-ve, me përjashtim të faktit që ato nuk kanë të drejtë të votojnë.

3.7 Detyrat e caktuara në Kodin Zgjedhor për organizimin dhe drejtimin e procesit të votimit, marrjes së materialeve të votimit, dorëzimit të tyre në KQZ, si dhe vendosja e marrëdhënieve me organet e tjera shtetërore janë detyra ekskluzive të anëtarëve me të drejtë vote në këto komisione. Në kryerjen e këtyre detyrave ekskluzive anëtarët pa të drejtë vote mund të ndihmojnë, por nuk mund të marrin përgjegjësi.

3.8 Anëtarët pa të drejtë vote kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo aktivitet të KZZ-ve apo KZQV-ve, që ka të bëjë me trajnimin e tyre, por jo detyrimisht me shpenzimet e shtetit.

3.9 Anëtarët pa të drejtë vote kanë të drejtë të marrin pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e KZZ-ve apo KZQV-ve. KZZ-të apo KZQV-të janë të detyruar që të njoftojnë rregullisht këta anëtarë për datën, orën, vendin dhe axhendën e mbledhjeve të tyre.

3.10 Anëtarët pa të drejtë vote kanë të drejtë të ngrejnë pretendimet e tyre në mbledhjet e KZZ-ve apo KZQV-ve. Pretendimet e tyre regjistrohen detyrimisht në procesverbalin e mbledhjeve, nga ana e sekretarit të KZZ-ve apo KZQV-ve.

3.11 Anëtarët pa të drejtë vote kanë të drejtë që të paraqesin me shkrim objeksionet e tyre, për çdo vendim të marrë në këto komisione. Këto objeksione i bashkëngjiten vendimeve të këtyre komisioneve.

3.12 Anëtarët pa të drejtë vote kanë të drejtë të marrin kopje të vendimeve të marra në KZZ apo KZQV, menjëherë pasi ato të jenë përfunduar ose zbardhur.

IV. Anëtarët pa të drejtë vote në KQV

4.1 Anëtarët pa të drejtë vote në KQV, caktohen sipas të njëjtës mënyrë që ky udhëzim parashikon në kreun II.

4.2 Pozita ligjore, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve pa të drejtë vote në KQV janë të njëjta me ato të parashikuara në kreun II të këtij udhëzimi.

V. Rregulla të fundit

5.1 Ky udhëzim ka fuqi për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë komisionet zgjedhore dhe anëtarët pa të drejtë vote.

5.2 Komisionet zgjedhore marrin masa për zbatimin e këtij udhëzimi menjëherë pas hyrjes në fuqi.

5.3 Udhëzimi shpallet në një vend të dukshëm nga komisionet zgjedhore, si dhe u dërgohet zyrtarisht partive politike të regjistruar në KQZ.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M Nr.30, datë 5.5.2001

PËR PARAQITJEN E DOKUMENTEVE DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR DEPUTET PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT 2001

Në mbështetje të neneve 45, 68 dhe 69 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për paraqitjen e dokumentacionit, regjistrimin dhe shpalljen e kandidatëve që konkurojnë për deputetë të drejtpërdrejtë dhe deputetë të listave shumëpartiake, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

1. Çdo person që kërkon të konkurojë për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën një emërore, si dhe çdo subjekt tjetër zgjedhor (parti apo koalicion) i regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që paraqet listë shumemërore dhe që plotëson kushtet që përcakton neni 45, 68 dhe 69 i Kushtetutës dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 22 ditë përpara datës së zgjedhjeve, ka të drejtë të paraqesë:

1.1 Në Komisionin e Zonës Zgjedhore ku dëshiron të kandidojë, për deputetë të drejtpërdrejtë:

- a) Dokument kandidimi për deputet në Kuvend, sipas modelit 6 (të miratuar nga KQZ-ja).
- b) Lista e 300 zgjedhësve që mbështesin kandidatin, sipas modelit 7.
- c) Deklaratë e subjektit zgjedhor (partisë ose koalicionit) që mbështet kandidatin, sipas modelit 8. Kjo deklaratë nuk është e nevojshme të dorëzohet nga kandidatët e pavarur.
- d) Në rastin e kandidatit të përbashkët subjektet që mbështesin kandidatin, në zbatim të nenit 66 pika “d”, duhet të deklarojnë me shkrim se cilës partie i llogaritet mandati i kandidatit nëse fiton, në rast të kundërt mandanti i tij shkon për llogari të partisë që ka fituar më shumë vota në shkallë vendi në raundin e parë.

1.2 Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për deputetë të listave shumemërore

Listën shumemërore për jo më pak se 20 kandidatë për deputetë, sipas modelit 6/2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Renditja e kandidatëve në listën shumemërore bëhet sipas vullnetit të subjektit zgjedhor (partisë ose koalicionit) që i paraqet. Pas miratimit dhe shpalljes së kësaj liste nga KQZ-ja, renditja e kandidatëve nuk ndryshohet.

Lista shumemërore shoqërohet edhe me:

- a) dokumentin e kandidimit për deputet të listës shumemërore në Kuvend, modeli 6/1, për çdo kandidat të përfshirë në listë;
- b) deklaratën e subjektit zgjedhor (partisë apo koalicionit) që mbështet kandidatin e listës shumemërore, sipas modelit 8/1.

1.3 Dokumentet e mësipërme, si rregull, paraqiten dorazi në komisionin respektiv dhe dorëzohen me procesverbal ku firmos kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit, sipas modelit 33 për KZZ-të dhe tek sekretari i KQZ-së, sipas modelit 9. Këto dokumente, menjëherë, bëhen hyrje në regjistrin e kandidatëve për deputet të KZZ-së apo KQZ-së.

2. KZZ-ja apo KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 19 ditë para datës së zgjedhjeve.

2.1 Para marrjes së vendimit për regjistrimin e kandidatëve për deputetë të drejtpërdrejtë apo të listës shumemërore, KZZ-ja apo KQZ-ja verifikon plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 45, 68 të Kushtetutës dhe të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe nëse vëren mospërputhje apo parregullsi në dokumentacion përpara mbarimit të afatit 19 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i jep mundësi kandidatit apo subjektit zgjedhor përkatës që paraqet listë shumemërore për të korrigjuar mangësitë, me kusht riparaqitjen e dokumenteve, brenda afatit 19 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Kur vërtetohet se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati apo subjekti zgjedhor është në rregull:

3.1 KZZ-ja në mbështetje të nenit 76 pika 1 të Kodit Zgjedhor merr vendim (sipas modelit 34):

- për regjistrimin e kandidatëve për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore apo,
- në mbështetje të nenit 76, 77 dhe 78 të Kodit Zgjedhor për mospranimin e dokumenteve, duke përcaktuar edhe arsyen e mosregjistrimit të kandidatit.

3.2 KZZ-ja, mbështetur në vendimin e mësipërm bën menjëherë shpalljen e kandidatëve të regjistruar, pranë çdo qendre votimi, sipas modelit 35, i lëshon çdo kandidati vërtetimin model 36, për regjistrimin si kandidat për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse dhe u komunikon vendimin për mosregjistrimin e kandidatëve përkatës.

3.3 KQZ-ja, mbështetur në nenin 81, 82 dhe 83 të Kodit Zgjedhor, merr vendimin për regjistrimin e listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës, sipas modelit 10, në të cilin shprehet edhe për kandidatët që nuk i regjistron duke përshkruar edhe arsyen e mosregjistrimit.

3.4 KQZ, mbështetur në vendimin e mësipërm dhe nenin 83 pika 2 të Kodit Zgjedhor, bën

shpalljen e listës veças për çdo parti politike apo koalicion, sipas modelit 11, si dhe lëshon vërtetimin për regjistrimin e çdo kandidati të listës shumemërore, sipas modelit 12, duke i komunikuar zyrtarisht subjektit përkatës vendimin për kandidaturat që nuk është pranuar të bëhet regjistrimi.

Modelet e dokumenteve që përmenden, i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr.31. datë 5.5.2001

PËR CAKTIMIN E AFATEVE KUR SUBJEKTET ZGJEDHORE DUHET TË PARAQESIN
PËRFAQËSUESIT E TYRE PËR NGRITJEN E KZZ-VE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 18 dhe të nenit 32 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2001 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” për të siguruar ecurinë normale të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 24.6.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Shtatë partitë politike, që kanë fituar më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 1997, të dërgojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda datës 15.5.2001, kandidatët e tyre për anëtar në të 100 KZZ-të.

2. Vendndodhja e qendrave të KZZ-ve është caktuar me vendim të KQZ-së nr.452 datë 27.4.2001 dhe iu është dërguar 7 partive politike që përmenden në pikën 1 të këtij udhëzimi, me shkresën tonë nr.616 datë 5.5.2001.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr.32, datë 8.5.2001

PËR REGJISTRIMIN E PARTIVE POLITIKE DHE KOALICIONEVE

Në mbështetje të nenit 12 dhe 13 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për regjistrimin e partive politike dhe koalicioneve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

1. Çdo parti politike apo koalicion që dëshiron të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 24 qershorit 2001, duhet të regjistrohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në afatet që vijnë:

- partitë politike jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve dhe
- koalicionet, jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, me kusht që secila parti pjesëmarrëse në koalicion të jetë regjistruar në KQZ si parti e veçantë brenda afatit 45 ditor.

1.1 Për t’u regjistruar do paraqiten dokumentet që vijnë:

- vërtetimin që partia është e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës,
- emrin mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët;
- emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e selisë së partisë;
- kopjen e vulës së partisë (stampim i njomë);

- emrin, adresën dhe numrin e telefonit të financierit të partisë;
- emrin, adresën dhe numrin e telefonit dhe faxit të personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

1.2 Dokumentet e paraqitura për regjistrim dhe pjesmarrje në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të tetorit 2000, nuk janë të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

2. Dorëzimi i dokumentacionit, si rregull, bëhet dorazi nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor përkatës, tek sekretari i KQZ-së, duke mbajtur procesverbal-dorëzimin në dy kopje.

3. Dokumentet e dorëzuara, shoqëruar me kopjen e procesverbalit, regjistrohen menjëherë në regjistrin përkatës të KQZ-së.

4. Për regjistrimin e koalicioneve do të paraqiten këto dokumente:

- Vendimi i KQZ-së për regjistrimin e secilës parti veças, si dhe
- Marrëveshjen e arritur midis partive pjesëmarrëse, e cila duhet të përmbajë:
 - emrin e koalicionit dhe siglën e tij;
 - emrin dhe siglat përkatëse të partive pjesëmarrëse në koalicion;
 - emrat e drejtuesve kryesorë të partive pjesëmarrëse në koalicion;
 - personin apo personat e autorizuar për të firmosur në emër të koalicionit;
 - stampën e vulës ose vulave që do të përdoren, si dhe
 - në afatin e përcaktuar në nenin 76 të këtij Kodi, listën shumëmbrore të koalicionit, sipas modelit 6/2, shoqëruar me modelin 6/1 dhe 8/1,
- 5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr.33, datë 8.5.2001

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË LISTAT E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT 2001

Në mbështetje të nenit 61 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

U D H Ë Z O N :

Për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 24.6.2001, të gjithë studentët me shkëputje nga puna (që nuk kanë vendbanimin e përhershëm të familjes së tyre në qytetin ku ka qendrën universiteti) që do të votojnë në konviktet e qendrës studentore ku kanë vendbanimin e përkohshëm (vendqëndrimin). Për realizimin e kësaj të drejte, të procedohet si vijon:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, me drejtoritë e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve të rretheve përkatëse, për studentët, familjet e të cilëve nuk kanë vendbanimin e përhershëm në qytetin ku ka qendrën universiteti dhe që banojnë në konvikte apo banesa me qira etj. në qytet, brenda datës 20.5.2001 duhet të kenë kryer regjistrimin e të gjithë studentëve, sipas formularit bashkëlidhur, grupuar sipas godinave të banimit me 800-1000 studentë për çdo qendër votimi.

2. Në datën 20.5.2001 ora 10 00, formularët e plotësuar dhe firmosur nga kujdestari i godinës drejtori i qendrës studentore, kundrejt një procesverbali, ia dorëzon supervisorit të KQZ-së në prefekturën përkatëse.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 11.5.2001
Doli nga shtypi më 12.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 100 lekë